

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PREMIUM MINERALS & ALLOYS "SH.P.K"

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" ("**Ligji Tregtar**");
- "Ligjet Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit", i ndryshuar"
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më (01/07/2024), me cilesinë e ortakut kemi redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, per krijimin e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në respektim te Kodit Civil, Ligjet Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe Ligjet Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit", i ndryshuar,
- 2) Une themeluesi, kam themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legislacionin e Republikës së Shqipërisë me emërtimin PREMIUM MINERALS & ALLOYS SH.P.K. (ne vijim "**Shoqeria**"):

- **ALI VISHAJ** i biri i Xhaferit, i datelindjes 17/06/1980, lindur në Deçan, Kosovë dhe banues në Vien, Austri, shtetas Austriak, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr. U 6170311

Neni 2:

Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në:
Shërbime të konsulencës dhe sherbime ne fushen e kerkimit, studimit te vendburimeve te mineraleteve, si dhe hapjen e agjencive perkatese per sherbime te tillë, te ndermjetesimit, studimit dhe projektimit te hapjes, perqatitjes e shfrytezimit te vendburimeve te mineraleteve te dobishme, shfrytezimit te mineraleteve te kromit, tregimi i mineralit te kromit, qymyrgurit, etj., Shitblerje, ndermjetesim dhe tregti te formave te ndryshme te mineraleteve te ndryshme brenda dhe jashtë vendit, te njohura ligji "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare" dhe Kodi Civil;
Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat deri në 31 dhjetor të vitit 2050 dhe mund të zgjatet edhe më tej me vendim te Asamblese se Pergjithshme.



Neni 4:
Selia

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. e Kavajës, Nd.4, Kati 8-të, Ap.32, K.Postar 1001, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresë të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Organi administrativ mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale, degë, agjenci, zyra përfaqësimi si dhe cfareadolloj entiteti tjeter të çdo lloji.
- (2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është www.pma.co
- (3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon info@pma.co

Kreu II
Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 ALL (dhjetemije leke). Pjesëmarra e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues Ali Vishaj: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 ALL që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve dhe shlyerjes të pjesëve të kapitalit themeltar përmes kontributeve në para dhe/ose kontributeve në natyrë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi .

Në rast zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit ne proporcione me kuotat që ata zotërojnë. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme qe vendos per zmadhimin e kapitalit duhet te vendos edhe afatin brenda te cilit duhet te kryhet shlyerja e tij. Në rast se zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë nuk nënshkruhet dhe shlyhet nga ana e të gjithë ortakëve brenda afatit te percaktuar ne vendim, atëherë pjesa e kapitalit të panënskruar mund të nënshkruhet dhe shlyhet proporcionalisht nga ortakët e tjere. Vetem nese keta ortake nuk e ushtrojne kete te drejte, pjesa e zmadhimit te kapitalit akoma e panënskruar dhe e pashlyer mund t'i ofrohet te treteve, me kusht qe kjo te jete parashikuar ne vendimin perkates te Asamblese se Pergjithshme. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme mbi zmadhimin e kapitalit rregullon termat dhe kushtet e tjera te ketij zmadhimi. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Nëse kapitali i Shoqërisë nuk nënshkruhet dhe shlyhet tërësisht, kapitali zmadhohet me një vlerë të barabartë me nënshkrimet dhe shlyerjet e mbledhura, vetëm nëse vendimi përkatës i Asamblesë së Pergjithshme e ka parashikuar shprehimisht.

Zmadhimi i kapitalit nuk mund të kryhet deri në momentin kur kuotat e emetuara më parë të janë shlyer tërësisht.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nukparashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organë Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse përmarrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes vijuese, nëse e para nuk arrin të mblidhet e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe në një vend të ndryshëm nga selia e Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkessë të shkruar drejtuar Administratorit/ve. Nëse Administratori refuzon te therrase Asamblene brenda 3 diteve pune nga kerkesa e ortakut, keta ortake kane te drejte te terrasin vete Asamblene ne perputhje me nenin 82, paragrafi i dyte, 83 (paragrafi i pare) dhe 84 (paragrafi i pare) te Ligjit Tregtar. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda muajit të qershorit, me qëllim që të diskutojë dhe miratojë bilancin vjetor të vitit të mëparshëm fiskal.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm, qofte edhe nepermjet autorizimit dhe të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Nëse përbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari.

Asambleja e Përgjithshme kryesoitet nga një Kryetar i zgjedhur nga ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e nevojshme, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë ortak.

Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe/ose autorizimet dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblënë e Përgjithshme dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmërisht. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.

Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë së Përgjithshme duhet të përgatiten menjëherë pas mbajtes së saj dhe duhet të nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga ligji dhe regjistrohen ne librin e vendimeve te Shoqerise.

Pavarësisht nga sa me siper, një vendim i Asamblese se Pergjithshme mund te merret vlefshmerisht edhe me ane te nje vendimi qarkullues me shkrim me kusht qe ky vendim qarkullues te nenshkruehet nga te gjithe ortaket. Propozimi i vendimit me te gjithe dokumentacionin e nevojshme svarues bashkengjitur duhet t'i dergohet me rradhe të gjithë ortakëve, me çdo mjet të pershtatshëm qe provon marijen e tij nga keta te fundit. Nga propozimi duhet të rezultojë në mënyrë të qartë çeshtja në rend të ditës dhe gjithe sa eshte e nevojshme për të siguruar informacionin e duhur mbi çeshtjen në fjalë, si dhe teksti përfundimtar i vendimit qe duhet nenshkuar. Krahas nenshkrimit te vendimit nga secili prej ortakeve, duhet shprehur ne vendim edhe menyra sesi ka votuar secili prej tyre. Kuorumi i vendimarrjes eshte ai qe eshte i parashikuar ne nenin 11 te Statutit. Do te konsiderohet date e vendimarrjes data ne te cilin eshte materializuar nenshkrimi i ortakut te fundit. Keto vendime dhe i gjithe dokumentacioni shoqëruar qe shpreh vullnetin e ortakeve duhet të regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.

Neni 10

Kuorumi i Pjesemarrjes

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë, te pakten, ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të Ligjit Tregtar ose ne rastet e parashikuara ne paragrafet (c) (emerimi i administratorit), (ç), (d) te nenit 8.1 (me perjashtim te shkarkimit te administratorit) dhe ne nenin 8.2 te statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, te pakten janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve/ Kuorumi i vendimarrjes

Asambleja e përgjithshme vodos me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne tri të katërtat e kapitalit, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë si dhe per ceshtjet e pershkuara:

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje si :

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve qe perfaqesojne te pakten 51% te kapitalit te Shoqerise, për çështje te tjera per te cilat statuti ose ligji nuk parashikon një shumice te ndryshme te cilesuar.:

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

13.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori i Vetëm, me perjashtim te rastit te parashikuar ne paragrafin e parafundit te nenit 14.

13.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

13.3 Administrator i Shoqërisë do të jetë: **IGLI ÇARÇANI** i biri i Dashnorit, i dtl. 11/04/1992, lindur në Lushnje dhe banues në Tirane, shtetas Shqiptar, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtws i kartws sw identitetit nr. J10411059A;;

13.4 Administratori mund të shkarkohet me vendim të ortakëve në çdo moment.

13.5 Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose palëve të treta për dëme të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të Ligjit.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ne perputhje me dispozitat dhe kufizimet e parashikuara ne ligj dhe/ose ne kete statut ose eventualisht ne vendimin e emerimit te tij nga Asamblea e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare ne perputhje me dispozitat dhe kufizimet e parashikuara ne ligj dhe/ose ne kete statut ose eventualisht ne vendimin e emerimit te tij nga Asamblea e Përgjithshme;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët Jane te detyruar te therasin Asamblene e Përgjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit Tregtar, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëdës;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Sidoqoftë, mirebesimi nuk perjashton pergjegjesine e Administratorit ne rast kur veprimi ose mosveprimi kryhet per shkak te neglizhencë se tij.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Tregtar, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti finanziar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja


Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Tregtar.

Kreu VI

Të tjera

Neni 20

Fitimet



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "John M.", is written over a blue curved line. Below the signature, the number "8" is handwritten.

Me kusht qe te jete respektuar nenit 77 i Ligjit Tregtar, fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor i Shoqerise - pasi i ështe zbritur edhe e gjithe shuma që Asambleja e Përgjithshme vendos lirisht të vërë mënjanë si rezerva diskrecionale, me voten pro te ortakeve te parashikuar ne paragrafin e pare te nenit 11 me siper - i shpërndahen ortakëve proporcionalisht me kuotat në kapitalin e Shoqërisë që ata kanë perkatesisht në pronësi.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë lirisht të mbajë te gjithe fitimet ose një pjese te tyre si rezerva, apo të shtyjë shpëndarjen e fitimeve – tërësisht apo pjesërisht – në vitet ushtrimore pasardhës.

Neni 21

E Drejta e Informacionit

Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e Shoqërisë kanë të drejtë të kerkojne, ne cdo moment, informacion nga Administratorët ne lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë dhe mbarevajtjen e saj.

Ortakët kanë detyrimin e konfidentialitetit ne lidhje me te dhenat dhe informacionet e marra gjatë ushtrimit të kontrollit, përveçse për qëllimin ekskluziv të mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe të Shoqërisë në rast procesi gjyqësor civil dhe penal.

Neni 22

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e Ligjit Tregtar, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

* Premium Minerals & Alloys SH.P.K*

ALI VISHAJ



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized letters and a surname. Below the signature, the name "ALI VISHAJ" is written in a clear, printed font.